

dialogu qeveridoronatorë

Buletin Informativ – Dhjetor 2010, Botimi nr. 45

Përpjekje e përbashkët e Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj dhe Sekretariatit Teknik të Donatorëve

www.dsdc.gov.al

www.aidharmonisation.org.al



Foto: Tryeza e Rrumbullakët Qeveri-Donatorë, e mbajtur më 3 dhjetor 2010

Përfundon me sukses Tryeza e Rrumbullakët Qeveri-Donatorë

Më 3 dhjetor 2010, Qeveria Shqiptare organizoi Tryezën e Rrumbullakët Qeveri-Donatorë, të drejtuar nga Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, z. Genc Pollo, dhe Ambasadorja e Zvicrës, znj. Yvana Enzler, si Kryetare e radhës e Sekretariatit Teknik të Donatorëve. Në këtë veprimtari morën pjesë zyrtarë të lartë të Qeverisë dhe komunitetit të donatorëve në Shqipëri. Në emër të Qeverisë së Shqipërisë, Ministri Pollo bëri një përmbledhje të arritjeve të mëdha dhe reformave të ndërmarra nga Qeveria brenda gjashtë muajve të fundit dhe impaktit të tyre në zhvillimin e Shqipërisë dhe integrimin e saj në BE. Ai përshëndeti vendimin e BE-së, të datës 8 nëntor 2010, për të hequr regjimin e vizave me Shqipërinë si një ngjarje historike dhe vuri në dukje se regjimi pa viza është çështje e lirisë dhe dinjitetit të çdo shqiptari, por që gjithashtu shoqërohet me përgjegjësi të mëdha. Ndërsa, për sa i përket Opinionit dhe rekomandimeve të Komisionit Evropian, Ministri Pollo tha se "Integrimi Evropian është prioriteti më i madh i Qeverisë shqiptare. Objektivi tjetër në procesin e integritit në BE është arritja e statusit të vendit kandidat," një objektivi që z. Pollo

kishte besim se Qeveria e tij do ta realizonte brenda këtij mandati. Në këtë kontekst, ai shpjegoi se raporti i fundit i Komisionit Evropian është për qeverinë një program pune për muajt dhe vitet e ardhshme. Trajtimi i prioritetëve dhe të metave të identifikuar në këtë raport janë bërë prioritet i Qeverisë. Ministri Pollo theksoi gjithashtu se progresi i konsiderueshëm është bërë në zbatimin e Axhendës së vendosur nga Deklarata e Parisit, duke cituar si dëshmi Planin e Veprimit për Harmonizim dhe përfundimin me sukses të Vlerësimit të Sistemeve të Prokurimit.

Ambasadorja Enzler iu drejtua tryezës në emër të komunitetit të donatorëve dhe shprehu kënaqësinë e tyre lidhur me progresin e konsiderueshëm në drejtim të zbatimit të Sistemit të Integruar të Planifikimit, dhe veçanërisht prezantimit kohët e fundit të mekanizmit të Monitorimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013, të bazuar në matjen e performancës, i cili do të ndihmojë edhe në përputhjen më të mirë të asistencës së jashtme me prioritetet e qeverisë. Ajo theksoi nevojën për bashkëpunim të mëtejshëm midis donatorëve dhe qeverisë për një bashkërendim më të mirë të ndihmës

financiare të ofruar nga BE për zgjerimin, me ndihmën e ofruar nga donatorët dytë dhe shumë-palësh, duke synuar përmbushjen e qëllimit kryesor për Shqipërinë, integrimin në BE. "Unë dua t'ju siguroj se të gjithë donatorët janë plotësisht të angazhuar në fuqizimin e partneritetit me qeverinë për të përmbushur kërkesat e BE-së dhe në vazhdimësinë e realizimit të zbatimit të axhendës për harmonizim", deklaroi ajo.

Drejtorja e DEBASKON-it, znj. Valbona Kuko, bëri një paraqitje të hollësishme të ecurisë së zbatimit të Sistemit të Planifikimit të Integruar dhe progresit të procesit të monitorimit të bazuar në indikatorët e performancës të SKZHI-së. Ajo theksoi se vendi tashmë ka arritur një stad ku kuadri strategjik është plotësuar dhe fokusi duhet të vendoset tek monitorimi. Drejtorja Kuko vlerësoi arritjet e punës së përbashkët mes qeverisë dhe komunitetit të donatorëve në përmirësimin e koordinimit nëpërmjet Grupeve Sektoriale të Punës (GSP), si dhe në përqafimin dhe adoptimin e mekanizmeve të rinj koordinues, të cilët synojnë llogaridhënien dhe menaxhimin kundrejt rezultateve.

Më shumë informacion për tryezën e rrumbullakët mund të gjendet [këtu](#).

Në këtë numër:

- Përfundime të Tryezës së Rrumbullakët Qeveri-Donatorë
- Programi i ri Një OKB 2012-2016
- Norvegjia forcon mbështetjen e saj për Programin Një OKB në Shqipëri
- KfW firmos pesë marrëveshje projektesh dhe kredish
- Qeveria e SHBA-së ndihmon të shpërngulurit nga përmbytjet e mëdha
- Konferencë e nivelit të lartë: “Integrimi Evropian – Realitete dhe perspektiva në dritën e Raportit Analitik të Komisionit Evropian”
- Zgjerimi i bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë & komuniteteve të migrantëve shqiptarë / diasporës së re për zhvillimin mes vendeve
- Konferencë për arsimin e vazhduar për specialistët e shëndetit
- Pjesëmarrja e shoqërisë civile në procesin e hartimit të politikave
- Bizneset përkrahin fuqimisht metodën one-stop-shop për licencimin në Shqipëri
- Reforma në Administratën Publike – Veprimtari e partnerëve
- Inaugurimi i Shërbimit për Punësimin e të Rinjve në Kukës
- BE dhe USAID prezantojnë projekte të reja për mbështetjen e sektorit të drejtësisë në Shqipëri
- Sondazhi i vitit 2011 për Monitorimin e Deklaratës së Parisit



■ Foto: Koordinatorja e Përherëshme e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, Zineb Touimi-Benjelloun, Ministri për Inovacionin dhe TIK Kryetari i KMO-së, Genc Pollo, dhe Drejtorja e DEBASKON, Valbona Kuko diskutojnë për Programin e ri Një OKB 2012-2016 në mbledhjen e Komitetit të Modernizimit të Qeverisë

Programi i ri Një OKB 2012-2016

Më 21 dhjetor 2010, Komiteti i Modernizimit të Qeverisë (KMO) – autoriteti më i lartë i politikave, koordinimit dhe vendim-marrjes së Qeverisë – zhvilloi një takim me Agjencitë e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri për të diskutuar strategjitë dhe fushat e mbështetjes së OKB-së për periudhën 2012-2016. Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit dhe njëkohësisht Kryetari i KMO-së, Genc Pollo, theksoi arritjet kryesore dhe mësimet e nxjerra nga Programi ekzistues Një OKB, që prej zanafillës së tij më 2007. “Me përfundimin e programit ekzistues në fund të vitit 2011,” deklaroi ai, “mund të themi me besim të plotë se Nisma Një OKB ishte një sukses për Shqipërinë dhe tashmë nuk ka kthim prapa. Qeveria e Shqipërisë është tërësisht e angazhuar për vijueshmërinë dhe thellimin e mëtejshëm të reformës së OKB-së si në nivel vendi, ashtu dhe në nivel global. Arritja më e rëndësishme është se prioritetet e programit Një OKB janë tërësisht në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013, si edhe me strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale. Programi ka kontribuar dhe ka mbështetur përpjekjet e Qeverisë në përgjigje të kërkesave për anëtarësim në BE... Ne vlerësojmë vizionin e ri dhe ndryshimet e konsiderueshme që solli Programi Një OKB nëpërmjet qasjes së “Të Katërve”: Një Drejtues, Një Program, Një Buxhet dhe Një Zë. Këto kanë kontribuar në përmirësimin e mëtejshëm të planifikimit strategjik dhe koordinimit të ndihmës së huaj, në përputhje me angazhimet për Deklaratën e Parisit dhe Programin për Veprim të Akrës.”

Anëtarët e Komitetit të Modernizim-

it të Qeverisë mirëpritën vendimin e OKB-së për të përgatitur Një Dokument për t'u nënshkruar me Qeverinë e Shqipërisë, duke zëvendësuar marrëveshje specifike midis agjencive të ndryshme të OKB-së. Ky është një hap i rëndësishëm në thellimin e reformës së OKB-së në nivel vendi. “Do të doja të theksoja rëndësinë e prioritetëve të qarta, të fokusuar dhe të artikuluar mirë, të cilat do të sigurojnë vijimin e programit të ardhshëm në të njëjtin nivel rëndësie sa ai i mëparshmi.” tha Z. Pollo. Koordinatorja e Përherëshme e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, Zineb Touimi-Benjelloun, falënderoi Ministrin Pollo dhe Qeverinë për leadershipin e fortë dhe angazhimin e treguar për zbatimin e programit ekzistues. Në prezantimin e saj, Znj. Touimi-Benjelloun paraqiti fushat e mbështetjes së OKB-së dhe rezultatet e pritshme për Programin 2012-2016, i cili u zhvillua pas konsultimeve të gjera me një numër të madh partnerësh kombëtarë e ndërkombëtarë. Fushat e propozuara për mbështetjen e OKB-së përfshijnë: qeverisjen / modernizimin e administratës publike, ekonominë dhe mjedisin, zhvillimin rajonal dhe vendor dhe politikën sociale gjithëpërfshirëse. Ajo përfundoi duke falënderuar komunitetin e donatorëve të cilët kanë mbështetur programin ekzistues, dhe shprehu optimizmin e saj për vazhdimësinë e këtij partneriteti nën Programin e Bashkëpunimit OKB – Qeveria e Shqipërisë 2012-2016. Programi i Bashkëpunimit OKB – Qeveria e Shqipërisë do të nënshkruhet në tetor 2011.

Norvegjia forcon mbështetjen e saj për Programin Një OKB në Shqipëri

Më 8 dhjetor 2010, Qeveria e Norveg-

jisë përtëriti angazhimin e saj për Programin Një OKB në Shqipëri, me një kontribut shtesë prej 806,452 dollarësh (5,000,000 kruna norvegjeze). Qeveria e Norvegjisë është mbështetëse e fuqishme e reformës së OKB-së, duke kontribuar fillimisht me 1,092,896 dollarë në dhjetor 2007. Kontributi më i fundit i Norvegjisë do t'i shkojë Fondit të Koherencës së OKB-së: një financim i paveçuar, shumë-vjeçar që rrit efikasitetin e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri duke lehtësuar, thjeshtuar dhe rritur harmonizimin dhe parashikueshmërinë e qarkullimit të asistencës. I udhëhequr nga Qeveria e Shqipërisë dhe duke u mbështetur në kontributin e 14 agjencive pjesëmarrëse, Programi Një OKB synon të rrisë në maksimum impaktin e OKB-së në pesë fusha kryesore: qeverisje më transparente dhe të përgjegjshme; pjesëmarrje më të madhe përfshirëse në politikën publike dhe vendim-marrje; qasje më të madhe dhe më të barabartë në shërbime cilësore bazë; zhvillim rajonal për të ulur pabarazitë; dhe zhvillim mjedisor të qëndrueshëm. Asistenca norvegjeze për vendet e Ballkanit Perëndimor ka si pikësynim në radhë të parë proceset kryesore të reformave kyçe dhe zhvillimit, dhe përqendrohet në përpjekjet humanitare, masat për fuqizimin e demokracisë, ndërtimin afatgjatë të kapaciteteve dhe zhvillimin e sektorit privat. Përpjekjet e Shqipërisë për integrimin evropian dhe arrijtjet nga ana e saj të Objektivave të Mijëvjeçarit për Zhvillim deri në vitin 2015 janë prioritetet kryesore.

KfW dhe Qeveria shqiptare nënshkruajnë pesë Marrëveshje me vlerë 65.6 Milion Euro

Në datë 23 Dhjetor 2010, Banka Gjermane për Zhvillim (KfW Entëicklungs-



■ Foto: Ambasadori i SHBA-së, Alexander Arvizu, vizitoi rajonin e përmbytur të Shkodrës dhe u takua me zyrtarë të qendrës së operacioneve të emergjencës, për të diskutuar për operacionet e tyre të ndihmës në kushtet e emergjencës. (Mirënjohje: Robert Manga, Ambasada e SHBA-së)

bank), e përfaqësuar nga Drejtoresha e Zyrës Rajonale për Shqipërinë dhe Kosovën, Ute Rodrian dhe qeveria e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministri i Financave, Ridvan Bode nënshkruan 5 marrëveshje me një vlerë prej 65.6 milion Euro, nga të cilat 16.9 milion janë grante të dhëna nga Komisioni Europian dhe 48,7 milion euro janë fonde të dhëna nga Qeveria Gjermane përmes KfW-së. Në përputhje me 'Axhendën e Parisit', KfW Entwicklungsbank është në krye përsa i përket financimeve të përbashkëta dhe të harmonizuara ndërmjet donatorëve, e cila bashkon burimet Europiane në mënyrë që të rritet impakti i këtyre financimeve. Marrëveshjet u nënshkruan për Programin për mbrojtjen e mjedisit në Liqenin e Ohrit – Menaxhimi i ujërave të zeza në Pogradec III, Programin e furnizimit me ujë të pijshëm në Shqipërinë e Mesme Komponenti Berat – Kuçovë, Programi i infrastrukturës komunale I, Fondi i investimeve sociale IV dhe Menaxhimi i mbetjeve urbane në Juglindje të Shqipërisë, programe që përfshihen në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve të Bashkëpunimit Shqiptaro-Gjerman për Zhvillim.

US Government Assists Displaced Following Severe Flooding

On 15 December 2010, the U.S. Ambassador to Albania, Alexander Arvizu, visited the flooded region of Shkodra and met with officials at the Government of Albania's disaster operations centre to discuss their emergency assistance operations. The Ambassador met with the Prefect of Shkodra, Maxhid Cungu, the Mayor of Shkoder, Lorenc Luka, and the President of the Albanian Red Cross, Dr. Shyqyri Subashi to discuss relief efforts. In his remarks to the media, the Ambassador affirmed the U.S. Government's commitment to support the Albanian people during both the emergency and long-term recovery efforts. The United States Embassy donated \$50,000 in emergency assistance to flood victims. The funds were disbursed through the U.S. Agency for International Development (USAID)'s Office of U.S. Foreign Disaster Assistance to the Albanian Red Cross for the purchase and distribution of blankets, hygiene kits, and other emergency relief supplies.

Konferencë e nivelit të lartë: Integrimi Evropian – Realitete dhe perspektiva në dritën e Raportit Analitik të Komisionit Evropian

Reagimet e Qeverisë Shqiptare ndaj Opinionit të Komisionit Evropian për kërkesën e Shqipërisë për anëtarësim në BE u diskutuan më 10 dhjetor 2010 gjatë konferencës Integrimi Evropian – Realitete dhe perspektiva në dritën e Raportit Analitik të



■ Foto: Ministri i Financave, Ridvan Bode dhe Drejtorja e Zyrës Rajonale të KfW-së për Shqipërinë dhe Kosovën, Ute Rodrian gjatë ceremonisë së firmosjes së marrëveshjeve të projekteve dhe kretimeve më 23 dhjetor 2010

Komisionit Evropian. Ministria e Integritimit Evropian organizoi veprimtarinë, e cila u zhvillua në kuadrin e projektit “Mbështetje për Ministrinë Shqiptare për Integrimin Evropian (SMEI II)”. SMEI II bashkë-financohet nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria Gjermane dhe zbatohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ). Konferenca u zhvillua në vijim të publikimit më 9 nëntor 2010 të Opinioni të Komisionit Evropian për kërkesën e Shqipërisë për anëtarësim në BE dhe Raportit Analitik që e shoqëronte këtë Opinion. Megjithëse Opinioni vlerëson se në përgjithësi Shqipëria ka bërë përparim të mirë, ai bën thirrje edhe për reforma të rëndësishme. Në fjalën e saj të hapjes, Ministria e Integritimit, Majlinda Bregu, prezantoi zbatimin me sukses të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me BE-në, por nënvizoi edhe nevojën për mbështetje dhe përkushtimin të gjitha forcave politike për të marrë pjesë në mënyrë të gjerë në këtë proces të vazhduar dhe për ta përmbyllur atë me sukses. I Ngarkuari me Punë i Delegacionit të BE-së në Tiranë, Luigi Brusa, dhe Ambasadori Gjerman në detyrë, e vunë theksin në kushtet dhe hapat teknikë që nevojiten për ta sjellë vendin në linjë me standardet evropiane. Të gjithë anëtarët e panelit ranë dakord se përgatitja e Shqipërisë për anëtarësim të plotë në BE do të jetë një proces i gjatë. Pjesëmarrësit në konferencë përbëheshin nga përfaqësues të autoriteteve shtetërore, anëtarë të parlamentit, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare. Projekti në zbatim 2 milion Euro do të vazhdojë të mbështesë kapacitetet e Ministrisë së Integritimit Evropian deri në vitin 2011.

Zgjerimi i bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë dhe komuniteteve shqiptare të migrantëve / diasporës së re për zhvillimin mes vendeve

Më 6 dhjetor 2010, IOM Tirana organizoi konferencën *Zgjerimi i bashkëpunimit ndërmjet qeverisë shqiptare dhe komuniteteve shqiptare të migrantëve / diasporës së re për zhvillimin mes vendeve* në bashkëpunim me Qeverinë shqiptare dhe Zyrën e Bashkëpunimit për Zhvillim të Ambasadës Italiane në Tiranë. Kjo veprimtari shënoi përfundimin e projektit *Plan-veprimi kom-*



Foto: Konferenca e nivelit të lartë: Integrimi Evropian – Realitete dhe perspektiva në dritën e Raportit Analitik të Komisionit Evropian

bëtar për Remitancat: Kalimi nga zhvillimi në zbatimin e politikave, i financuar nga Bashkëpunimi Italian për Zhvillim dhe i zbatuar nga IOM Tirana. Në të morën pjesë institucione të qeverisë shqiptare, përgjegjëse për politikën e migracionit, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe aktorë ndërkombëtarë, institucione financiare që menaxhojnë remitancat dhe investimet në vend, si dhe përfaqësues të diasporës së re të Shqipërisë (domethënë, shqiptarët të cilët emigruan pas viteve 90, kanë kaluar në shumë e një dhjetëvjeçar jashtë vendit, kanë status të rregullt dhe janë të mirë-integruar në vendet e tyre të reja, për shembull, Greqi, Itali, Mbretëri e Bashkuar dhe Gjermani). Diskutimet eksploran partneritetet e ndryshme ndërmjet Qeverisë dhe komuniteteve shqiptare jashtë vendit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë zhvillimit njerëzor dhe ekonomik. Në fjalën e saj të hapjes, Shefja e Misionit të IOM-it në Tiranë, Nicoletta Giordano, vuri në dukje kontributet e rëndësishme të diasporës së re në zhvillimin e vendit, si dhe rolin e katalizatorit që ka luajtur Qeveria. Ajo kujtoi *Forum Global të kohëve të fundit për Migracionin dhe Zhvillimin (GFMD) për Partneritetet për migracionin dhe zhvillimin njerëzor: përparim i përbashkët-përgjegjësi e përbashkët,* i cili u zhvillua në nëntor 2010 në Meksikë. Forumi GFMD, në të cilin Shqipëria merr pjesë rregullisht, shkoi përtej debateve të zakonshme ekonomike për efektet dhe pasojat e migracionit dhe në vend të tyre u përqendrua në dimensionet njerëzore

të tilla si shëndeti, arsimi, përkatësia gjinore, të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e të gjithë migrantëve. Ambasadori Italian në Shqipëri, Saba D’Elia, nënvizoi gjithashtu rolin e rëndësishëm që luan komuniteti shqiptar në Itali. Rreth 400,000 shqiptarë jetojnë në Itali, ku ata përfaqësojnë komunitetin e dytë më të madh të imigrantëve. Ata janë të integruar mirë në tregun e punës dhe janë bërë pjesëtarë aktivë të shoqërisë civile. Prandaj, nxitja e bashkëpunimit ndërmjet qeverisë shqiptare dhe komuniteteve të migrantëve jashtë vendit, si dhe nxitja e përdorimit të kanaleve formale për transferimin e kursimeve të tyre do të mbeten përparësi e Bashkëpunimit Italian për Zhvillim të bashkuar me IOM-in. Zëvendës-ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të barabarta, Kastriot Sulka, vuri në dukje se edhe Qeveria Shqiptare i nxit qytetarët të kthehen nëse dëshirojnë. Strategjia “Përi-integrimin e qytetarëve shqiptarë të kthyer 2010 – 2015” dhe Plani i saj i Veprimtari përfshijë ta bëjnë kthimin më të qëndrueshëm, duke lehtësuar procesin e ri-integritimit, duke minimizuar kostot e migracionit dhe duke rritur në maksimum përfitimet. Konferenca doli me një numër rekomandimesh se si të forcohen partneritetet ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe diasporës, përfshirë: forcimin dhe zgjerimin e kanaleve institucionale ekzistuese të komunikimit me diasporën (përmes Institutit Kombëtar të Diasporës në MPJ, Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve dhe subjekteve të tjera shtetërore); rritjen e

angazhimit të diasporës në dialogun e hapur me politikë-bërjen në Shqipëri; organizimin në mënyrë të rregullt të veprimtarive të ngjashme nga Qeveria e Shqipërisë dhe partnerët.

Pjesëmarrja e shoqërisë civile në procesin e hartimit të politikave - standard i qeverisjes demokratike

Projekti “Fuqizimi i shoqërisë civile dhe strukturave demokratike në Shqipëri”, i financuar nga GTZ përmes agjencisë së konsulencës GOPA, ishte një nismë e Qeverisë Shqiptare për të promovuar pjesëmarrjen e shoqërisë civile në procesin e hartimit të politikave dhe në vendimmarrje si një standard i qeverisjes demokratike dhe për krijimin e një procesi të vazhdueshëm përfshirjeje të aktorëve të Shoqërisë Civile. Në zbatimin e tij, ky projekt përfshiu strukturat e qeverisjes qendrore, Këshilli i Ministrave, Ministria e Brendshme dhe



Foto: Konferenca Zgjerimi i bashkëpunimit ndërmjet qeverisë shqiptare dhe komuniteteve shqiptare të migrantëve / diasporës së re për zhvillimin mes vendeve

Ministria e Integritimit Evropian. Ceremonia që shënonte mbylljen e këtij projekti u zhvillua më 16 dhjetor 2010. Në ceremoni morën pjesë përfaqësues të qeverisë, organizatave ndërkombëtare dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Ceremonia u përshëndet nga Sekretari i Përgjithshëm pranë Kryeministrit, Z. Gjergj Lezha i cili theksoi se mbështetja e palës gjermane ka qenë decisive për progresin e kryer dhe se bashkëpunimi në kuadër të këtij projekti qe-

veria shqiptare e konsideron mjaft të suksesshëm. Ajo që u arrit përmes këtij projekti ishte ndërtimi i kornizës institucionale, që siguron dhe nxit pjesëmarrjen e qytetarëve në qeverisje. Objektivi ishte që kjo kornizë, pasi të institucionalizohet, të mos mbetet në letër, por të shndërrohet në një element që do të shoqërojë performancën dhe funksionimin rutinë të të gjitha niveleve të qeverisjes. Ndërsa drejtuesja e projektit, Znj. Valdet Sala bëri një paraqitje të aktiviteteve dhe arritjeve të projektit ndër të cilat me rëndësi për t'u përmendur janë: Krijimi/alokimi nga qeveria i Fondit për mbështetjen e Shoqërisë Civile, si pjesë integrale e buxhetit të shtetit; marrja e nismës ligjore që e sanksionon këtë fond, nëpërmjet miratimit të ligjit “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”; asistenca për krijimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile deri në bërjen funksionale të saj; hartimi dhe miratimi nga përfaqësuesit e Shoqërisë Civile dhe qeverisë (nëpër-



Foto: Ceremoni mbyllëse e projektit Fuqizimi i shoqërisë civile dhe strukturave demokratike në Shqipëri, organizuar më 16 dhjetor 2010

Konferenca për arsimin e vazhduar për specialistët e shëndetësisë shënon përparimin e arritur dhe përcakton sfidat

Më 9 dhe 10 dhjetor 2010, Ministria e Shëndetësisë, së bashku me Zyrën Zvicerane për Bashkëpunim në Shqipëri (SCO-A) dhe Qendrën Kombëtare për Arsimin e Vazhduar zhvilluan një konferencë për arsimin e vazhduar mjekësor të specialistëve të shëndetësisë. Kjo veprimtari u organizua në kuadrin e Projektit për Zhvillimin Profesional, të financuar



Foto: Ambasadorja e Zvicrës, Sh. S. Yvana Enzler, duke mbajtur fjalën e hapjes në konferencën për arsimin e vazhduar mjekësor të specialistëve të shëndetësisë

nga Zvicra. Konferencën e hapën Ministri i Shëndetësisë, Petrit Vasili, dhe Ambasadorja e Zvicrës, Yvana Enzler. Specialistët e shëndetësisë nga Zvicra, Shqipëria dhe disa vende të tjera paraqitën përvojat e tyre dhe përcaktuan hapat e mëtejshëm që nevojiten për përmirësi-

min e arsimit të vazhduar mjekësor në Shqipëri. “Një fuqi punëtore moderne për shëndetësinë duhet të përmirësojë vazhdimisht njohuritë dhe aftësitë e saj”, tha Drejtorja e Qendrës Kombëtare për Arsimin e Vazhduar, Entela Shehu. Ajo shtoi gjithashtu se “Shqipëria, falë mbështetjes nga Zvicra, është në rrugën e duhur drejt krijimit të arsimit të vazhduar për punonjësit e shëndetësisë”. Qendra Kombëtare për Arsimin e Vazhduar u formua me mbështetjen e qeverisë zvicerane, për të ofruar akreditim dhe ricertifikim për specialistët e shëndetësisë për të ndjekur arsim të vazhduar.

mjet takimeve te shumta rajonale) i draftit të "Dokumentit Politik të Bashkëpunimit Qeveri/Shtet me Shoqërinë Civile", i quajtur Karta e Shoqërisë Civile, që pritet të adaptohet nga Parlamenti; gjallërimi i një praktike dhe procesi bashkëpunimi midis aktorëve të Shoqërisë Civile dhe aktorëve qeverisës në të gjitha nivelet, nëpërmjet eksperiencave konkrete në proceset e konsultimit të projekt-ligjit si dhe të draft kartës së Shoqërisë Civile.

Ky projekt synonte krijimin e një klime politike mirëbesimi midis Qeverisë dhe shoqërisë civile jo vetëm nëpërmjet shprehjes publike të vullnetit të mirë për bashkëpunim, por dhe përmes konkretizimit me nisma ligjore e institucionale, që mundësojnë hapësirat e domosdoshme për përfshirjen e shoqërisë civile në proceset qeverisëse. Demonstrimi i modeleve më të mira evropiane të qeverisjes, që kanë rezultuar të suksesshme në sajë edhe të përfshirjes së qytetareve në qeverisje, si dhe të angazhimit strategjik të institucioneve të shoqërisë civile, ka qenë reference e punës së këtij projekti.

Konferencë e biznesit shqiptar dhe sloven

Më 8 dhjetor 2010, Forumi Ekonomik Shqiptaro-Sloven organizoi një konferencë, e cila u hap nga Kryeministri shqiptar Sali Berisha dhe Kryeministri sloven Borut Pahor. Në të morën pjesë më shumë se 107 përfaqësues nga të gjithë sektorët e biznesit sloven. Kryeministri Pahor i vlerësoi pozitivisht arritjen e Shqipërisë në vitet e fundit dhe konfirmoi se së shpejti 20 kompani slovene planifikojnë të hapin ndërmarrje biznesi në Shqipëri. Kryeministri sloven tha se Shqipëria do të jetë destinacioni i fundit në Evropë dhe në qendër të investimeve slovene. "Slovenia po kërkon treg të ri në Evropë për investime në sektorë të ndryshëm dhe Shqipëria do të jetë në fokus të investitorëve slovenë. Shqipëria është një vend ku vlen të investohet, sepse ka lehtësira për biznesin. Dhe të dyja qeveritë janë të vendosura ta rrisin bashkëpunimin në këtë drejtim. Prandaj, ne vendosëm të formojmë Këshillin e Biznesit, me qëllim që të dyja vendet të bashkëpunojnë ngushtë për nxitjen e investimeve," deklaroi Pahor. Nga ana e tij, Kryeministri Berisha



Foto: Kryeministri Sali Berisha dhe Kryeministri i Slovenisë, Borut Pahor, mbajnë fjalët e tyre në Konferencën e biznesit shqiptar dhe sloven, të organizuar më 8 dhjetor 2010

i ftoi bizneset slovene të investojnë në Shqipëri, ku do të gjenin taksat më të ulëta në Evropë. Kryeministri theksoi se reformat që ka zbatuar qeveria e tij vitet e fundit e kanë bërë Shqipërinë mjedis shumë të favorshëm për investitorët e huaj. Konferenca u mbyll kur Zëvendës Ministri i Punëve të Jashtme, Selim Belortaja, dhe Drejtori i Përgjithshëm për Diplomacinë Ekonomike dhe Bashkëpunimin për Zhvillim në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Slovenisë, Vladimir Gasparic, nënshkruan një protokoll bashkëpunimi.

Public Administration Reform - Stakeholder Event

On 1 December 2010, the Department of Public Administration (DoPA) organized a "Stakeholder Event on Public Administration Reform" funded by the European Union and the Federal Government of Germany. The aim was to

re-energize the Government's efforts after one year of Public Administration Reform (PAR) Strategy implementation. The event brought together more than 60 participants from the key stakeholder institutions, including 5 Deputy Ministers representing the Inter-ministerial working group on public administration. The head of German International Cooperation (GIZ) Office Albania, Gantzer-Sommer, underscored the need for PAR to adopt standards in line with *acquis* as part of Albania's effort to achieve EU membership. All Deputy Ministers expressed their support to realizing the PAR strategy and recognized the importance that civil service reforms are actually implemented. A number of concrete steps, focusing on revitalising the working groups on PAR, increasing effort in collecting information from stakeholders and the revision of the action- and monitoring plans, were pointed out by DoPA Director, Blerta Selenica at the conclusion of the meeting.



Foto: Veprimtaria me partnerët për reformën e administratës publike, e organizuar nga Departamenti i Administratës Publike më 1 dhjetor 2010

Bizneset mbështesin fuqimisht metodën one-stop-shop të licencimit në Shqipëri

Sipas konstatimeve kryesore të sondazhit, të shpallura sot nga organizata jo fitimprurëse Partners Albania, Qendra Kombëtare e Licencimit (OKL) one-stop-shop i ka ulur ndjeshëm kohën dhe përpjekjet e bizneseve për të siguruar licenca ose leje në Shqipëri. Këto rezultate u paraqitën në tryezën e rrumbullakët të zhvilluar në dhjetor me përfaqësues të komunitetit të bizneseve. Programi Prag II i Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit II (MCCA2), i administruar nga USAID, e formoi Qendrën Kombëtare të Licencimit në qershor 2009 dhe kjo Qendër funksionon në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Qendra ka përpunuar më shumë se 2,000 kërkesa në pesë muajt e fundit dhe kërkesa për shërbimet e saj është në rritje. Studimi konstatoi se Qendra ka arritur nivel shumë të lartë vlerësimi nga bizneset në drejtim të paanësisë, transparencës dhe efektivitetit. Tryeza e rrumbullakët në Tiranë ishte pjesë e raundit të dytë të konsultimeve të OKL-së me komunitetin e biznesit, me mbështetjen e MCCA2, me synim përmirësimin e mëtejshëm të gamës dhe cilësisë së shërbimeve të saj.

BE vazhdon mbështetjen për reformën e gjyqësorit

Një projekt i ri prej 2.3 milionë eurosh, i financuar nga BE për të mbështetur forcimin e sundimit të ligjit në Shqipëri, u prezantua zyrtarisht më 17 dhjetor 2010. Projekti, *Konsolidimi i sistemit të drejtësisë në Shqipëri (EURALIUS)* do të ndihmojë Ministrinë shqiptare të Drejtësisë dhe institucionet gjyqësore të zhvillojnë sistem drejtësie të pavarur, të paanshëm, eficient, transparent dhe modern. Projekti synon të ndihmojë në ndërtimin e besimit të mëtejshëm publik në këto institucione, në konsolidimin e demokracisë dhe të shtetit ligjor në vend. Opinioni dhe Raporti Analitik i publikuar kohët e fundit nga Komisioni Evropian theksoi seriozisht rëndësinë e reformës në sundimin e ligjit dhe në drejtësi për hyrjen e Shqipërisë në BE. Këshilli i BE-së e ka miratuar Opininionin e Komisionit dhe ka riafirmuar se zhvillimi i ardhshëm i Shqipërisë do të përqendrohet në dymbëdhjetë



■ Foto: Tryezë e rrumbullakët e Qendrës Kombëtare të Licencimit me biznesin, e mbajtur në Tiranë më 1 dhjetor 2010

prioritete kryesore të përcaktuara nga Komisioni, përfshirë forcimin e shtetit ligjor dhe reformën në drejtësi. Projekti ka sjellë në vend 5 ekspertë ndërkombëtarë afatgjatë nga vende të ndryshme anëtare të BE-së, të cilët bashkë me 2 ekspertë vendorë do të punojnë gjatë 30 muajve të ardhshëm për organizimin e drejtësisë dhe reformën në drejtësi, modernizimin e gjyqësorit, ekzekutimin e aktvendimeve, administrimin e gjykatave dhe menaxhimin e çështjeve, drejtësinë penale dhe pjesëmarrjen. Gjatë ceremonisë së prezantimit, i Ngarkuari me Punë i Delegacionit të BE-së, Luigi Brusa, theksoi se “reformimi i sistemit të drejtësisë nuk mund të jetë punë shkel e shko. Ai nuk mund të bëhet me vendime të rastit. Shteti ligjor duhet të burojë nga një vizion i gjithanshëm dhe strategji gjithëpërfshirëse drejt objektivave të transparencës, përgjegjshmërisë dhe eficientësisë”. Duke folur për rëndësinë e shtetit ligjor për demokracinë funksionale, ai shtoi se “një gjë e tillë si ‘sundim i ligjit për shu-

micën’, ose ‘sundim i ligjit për opozitën’ nuk ekziston. Konsensusi i gjerë politik ndërmjet forcave politike për reformën e drejtësisë është kusht i nevojshëm për përparim”. Projekti po zbatohet nga Ministria Spanjolle e Drejtësisë në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Gjyqësorit Italian.

Seminar për shërbimet e provës

Më 14 dhjetor u zhvillua tryeza e parë e rrumbullakët për të vlerësuar përvojat dhe praktikatat e mira dhe për të përcaktuar rrugët për forcimin e partneritetit ndërmjet shërbimeve të provës dhe OJQ-ve. Kjo veprimtari u organizua nga Ministria e Drejtësisë (Shërbimet e Provës) dhe Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI), me mbështetjen e UNICEF-it. Zëvendës Ministria e Drejtësisë, Brikena Kasmi, theksoi se reforma e gjyqësorit përfshin edhe rritjen e kapacitetit të shërbimeve



■ Foto: 14 dhjetor 2010 - Zëvendës Ministria e Drejtësisë, Brikena Kasmi, Drejtori i Shërbimit të Provës, Arben Sefgjini, përfaqësues i UNICEF-it, Detlef Palm, dhe Drejtorja e QSHPLI-së, Holta Zaçaj, drejtojnë diskutimet për Shërbimet e Provës

të provës, të ngritura rishtazi. Ajo theksoi se masat jo të parburgimit dhe largimi nga rruga e gabuar e të miturve të cilët kanë probleme me ligjin, kanë rëndësi kyçe. Drejtori i Shërbimit të Provës, Arben Sefgjini, paraqiti programin dhe sfidat e shërbimeve të provës dhe hapat e nevojshëm për plotësimin e kuadrit ligjor. Përfaqësuesi i UNICEF-it, Detlef Palm, nënvizoi rëndësinë e përmirësimit të shërbimeve të provës për të miturit. "Prova nuk është thjesht një punë e përditshme për personin në provë, ose për oficerin e provës, apo për punonjësën sociale. Shërbimet e provës duhet të tregojnë dhembshuri dhe mirëkuptim, dhe gatishmërinë për të lidhur njerëzit me njëri-tjetrin, me qëllim që ata të mund të mësojnë nga njëri-tjetri Trajtimi i të miturve duhet të jetë i ndryshëm nga ai i të rriturve, me shërbime të tjera plotësuese, përfshirë formimin profesional. Vitin e shkuar, rreth 42% e dënimeve të gjykatave për të miturit të përfshirë në fazën pilot iu përcollën organizatave të shoqërisë civile dhe shërbimit të provës, dhe ne duam që kjo shifër të rritet. Dhe ne duam që të miturit të rivendosin lidhjet me të tjerët, me qëllim që të arrijnë të gjejnë punë dhe të bëjnë një jetë të denjë" tha Palm. Holta Zaçaj (OSHPLI), Don Marek Grun (Don Bosco) dhe përfaqësues të tjerë të OJQ-ve shkëmbyen përvojat dhe sfidat për partneritet më të mirë ndërmjet shoqërisë civile dhe shërbimit të provës.

USAID prezanton Projektin e ri në mbështetje të sistemit të drejtësisë në Shqipëri

Më 21 dhjetor 2010, USAID, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë, organizoi konferencën "Për një drejtësi më transparente, të efektshme dhe të përgjegjshme në Shqipëri", për të diskutuar mbi sfidat dhe mundësitë me të cilat ballafaqohet sot sistemi i drejtësisë në Shqipëri, si dhe për prezantuar Programin e ri të USAID-it për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri (JuST). Pjesëmarrësit në Konferencë ishin kryetarë dhe kancelarë gjykatash nga i gjithë vendi, përfaqësues të shoqatave profesionale në fushën e drejtësisë, nga shoqëria civile, dhe media. Diskutimet në Konferencë u përqendruan në mënyrat për krijimin e një sistemi më të fortë të arsimit të lartë juridik dhe trajnimit të vazhdueshëm profesional,



Foto: Drejtori i Misionit të USAID-it, Joseph C. Williams, bashkë me Ministrin e Drejtësisë, Bujar Nishani, dhe Kryetarin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Kreshnik Spahiu, mbajtën fjalimet me rastin e prezantimit të Projektit për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri (JuST)/ Mirenjohje: USAID

përmirësimin e vetë-rregullimit të avokatisë, si dhe marrëdhënie më të mira ndërmjet gjykatave nga njëra anë dhe shoqërisë civile e medias nga ana tjetër. Programi i USAID-it për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri (JuST) është një projekt pesëvjeçar, i cili synon rritjen e transparencës, paanshmërisë dhe efektshmërisë në gjykata, konsolidimin e rolit mbikëqyrës dhe antikorrupsion të organizatave të shoqërisë civile dhe medias, si dhe forcimin e arsimit juridik dhe avokatisë në Shqipëri.

Inaugurimi i zyrës së Shërbimit për Punësimin e të Rinjve në Kukës

Më 3 dhjetor 2010, në Zyrën Rajonale të Punësimin në Kukës u inaugurua Shërbimi për Punësimin e të Rinjve. UNICEF ndihmoi në transferimin e aftësive të nevojshme, ofroi pajisje dhe ndihmoi në kryerjen e shërbimit të parë,

në kuadrin e programit të Qeverisë për Punësimin dhe Migracionin e të Rinjve, me mbështetjen e tre agjencive të OKB-së. Shërbimi për Punësimin e të Rinjve ofron: shpallje të vendeve të punës, pannaire të punëdhënësve, vlerësime dhe udhëheqje në karrierë, mundësi për arsim dhe formim profesional; këshillim individual për punësim për të rinj të moshave 16 deri në 29 vjeç; shërbime të gjetjes së vendeve të punës, mundësi për praktikë punë dhe punësim sezonal; paketa informative për punësimin dhe arsimimin e të rinjve; zhvillim rezumeje, si dhe përgatitje dhe planifikim për punësim; këshillim për të drejtat e punës dhe informacion për kontratat e punës; kushtet e shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës; dhe informacion për mobilitet të sigurt (lidhur me migracionin). Në komentet e tij, përfaqësuesi i UNICEF-it, Detlef Palm, u kujtoi të rinjve se "ne kemi gjithnjë nevojë për këshilla të mira ose një mendim të dytë kur bëhet fjalë për vendime të mëdha për karrierën tonë. Këto shërbime mund t'ju ndihmo-



Foto: 3 dhjetor 2010 – Inaugurimi i zyrës së Shërbimit për Punësimin e të Rinjve – Dorëzimi i certifikatave të diplomuarve të një programi formimi profesional në Kukës

jnë. Por është iniciativa juaj ajo që bën ndryshimin. Përpiquni të ruani kontrollin mbi të ardhmen tuaj dhe jetën tuaj. Zbuloni shpirtin tuaj të sipërmarrjes!" Në veprimtarinë e inaugurimit morën pjesë Kryetari i Bashkisë së Kukësit, Hasan Halilaj, Ambasadori i Mbretërisë së Spanjës, Manuel Montobio, dhe përfaqësues të Shërbimeve Kombëtare dhe Rajonale të Punësimit. Programi financohet nga Qeveria e Spanjës nëpërmjet kontributit të saj në Fondin e Arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Mi-jëvçarit.



■ Foto: 7 dhjetor 2010 – Forumi i studentëve të gazetarisë me rastin e Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës kundër Grave

Dita ndërkombëtare për eliminimin e dhunës kundër grave

"Dhuna kundër grave është gjithmonë e papranueshme; ajo është gjithnjë shkelje e të drejtave të njeriut; është kundër ligjit. Është gjithnjë krim. Mendoj se të gjithë jemi dakord për këtë. Por a bëjmë gjë për këtë? – tha përfaqësuesi i UNICEF-it në Shqipëri, Detlef Palm, gjatë një takimi me studentë të gazetarisë. Takimi u mbajt në kuadrin e 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore, veprimtari e përditshme e organizuar nga Grupi Gjinator i Punës i OKB-së, në bashkëpunim me Qeverinë e Shqipërisë. Në takim morën pjesë edhe përfaqësues të nivelit të lartë të Ambasadës Amerikane, Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta dhe shoqërisë civile, të cilët shprehën mbështetjen e tyre për qëndrimin e Z. Palm. Studentët që morën pjesë në takim i pritën pozitivisht këto komente. Media, u theksua, luan një ndër rolet më të rëndësishme në ndryshimin e qëndrimeve, për shkak të shtrirjes së gjerë të saj në publik. Gazetarët nuk janë vetëm vëzhgues dhe raportues; ata janë në gjendje të bëjnë ndryshimin. Ata duhet të marrin drejtimin jo vetëm në 16 ditët e aktivizmit, por për aq kohë sa do të duhet për t'i dhënë fund dhunës në familje dhe dhunës kundër grave.

Drejt krijimit të qasjes sektoriale në mjedis

Më 16 dhjetor 2010, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujit organizoi takimin e rregullt të grupit sektorial të punës për mjedisin. Në ta-

kim u dha informacion i përgjithshëm për zhvillimet e ndryshme në sektorin e mjedisit gjatë vitit 2010, përfshirë përparimin e bërë në legjislacionin për mjedisin, u bë një vështrim i përgjithshëm i planit të punës të Ministrisë për vitin 2011, dhe u diskutua për rezultatet paraprake të punës së kryer në përgatitjen e Planit Operativ për Sektorin e Mjedisit, me synim mundësimin e realizimit të një Qasjeje Sektoriale. Plani Operativ do t'i shndërojë politikat e Qeverisë në objektiva operative dhe do t'i integrojë ato me realitetet financiare të shprehura në kuadrin buxhetor shumëvjeçar dhe një-vjeçar të Qeverisë. Përpilimi i Planit Operativ për Sektorin e Mjedisit organizohet nëpërmjet analizave, intervistave dhe seminareve, ku Plani ndërtohet hap pas hapi. Seminari i parë një-javor u zhvillua në fund të tetorit 2010; seminare të tjera janë planifikuar për në fillim të pranverës 2011. Këto seminare do të plotësohen me veprimtari të tjera si intervista me palë të interesuara dhe promovimi i Planit tek institucionet shtetërore, donatorët dhe media. Kjo nismë bëri thirrje për takime informuese të administratës shqiptare, në nivele politike dhe administrative, të organizuara nga udhëheqja politike e Ministrisë dhe nga grupi bërthamë i punës. Donatorët e sektorit u ftuan ta mbështesin këtë proces.

Konferenca 2010 për asistencën para aderimit (IPA) për vendet e Ballkanit Perëndimor, Islandën dhe Turqinë

Në datat 6 dhe 7 dhjetor 2010, Komisioni Evropian dhe Banka Botërore organizuan një konferencë dy-ditore në Bruksel për të diskutuar se si Instru-

menti për Asistencën Para-aderimit (IPA) mund të zbatohet për të pasur efektin maksimal në vendet e Ballkanit Perëndimor, Turqi dhe Islandë. Konferenca trajtoi gjithashtu bashkëpunimin ndërkufitar për vendet e Ballkanit Perëndimor. Në të u diskutua edhe për rolin e ndihmës financiare për vendet e Ballkanit Perëndimor, Turqinë, dhe Islandën, dhe rolin e vetë këtyre vendeve në përpjekjet e tyre për anëtarësim në BE. U rekomandua një partneritet më i gjerë ndërmjet BE-së, institucioneve financiare evropiane dhe Bankës Botërore për t'i ndihmuar këto vende në vazhden e krizës financiare. Pjesëmarrësit shqyrtuan se si mbështetja politike dhe ekonomike, ndihma financiare e BE-së dhe mbështetja financiare nga donatorët mund të bëhen më koherente dhe të sjellin forcim të ndërsjellë, veçanërisht në drejtim të përshtatjes së IPA-s në këtë objektiv. Konferenca shërbeu për të nisur konsultimin me partnerët lidhur me të ardhmen e asistencës para-aderimit pas vitit 2013. Pjesëmarrësit patën mundësinë të përcaktojnë tonin e debatit se çfarë forme duhet të marrin mekanizmat financiar të BE-së për të ndihmuar më së miri ndryshimin e qëndrueshëm dhe reformat e efektshme. Dita e dytë u përqendrua në bashkëpunimin ndërkufitar midis vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ky takim dha një panoramë të përpjekjeve dhe arritjeve rajonale gjatë periudhës 2007-2010, dhe diskutoi për perspektivat e ardhshme të bashkëpunimit ndërkufitar në rajon. Konferenca tërhoqi më shumë se 450 pjesëmarrës, përfshirë ministra dhe zyrtarë të lartë të shteteve përfituese si dhe të agjencive donatore, institucioneve financiare ndërkombëtare dhe organizatave të shoqërisë civile.

Dita ndërkombëtare kundër HIV/AIDS

“Qasja në shërbime cilësore shëndetësore dhe sociale dhe qytetarët e mirëinformuar janë kryesore në ndalimin e përhapjes së HIV/AIDS-it” ishte mesazhi i përbashkët në fund të tryezës së rrumbullakët që organizoi Programi Kombëtar për HIV/AIDS-in në partneritet me agjencitë e OKB-së në Ditën Ndërkombëtare kundër HIV/AIDS-it më 1 dhjetor 2010. Diskutimi u përqendrua në sfidat dhe pengesat kryesore për të luftuar përhapjen e HIV/AIDS dhe për të zhvilluar programet e kontrollit dhe trajtimit. Qeveria ka ndërtuar një strategji kombëtare dhe plan veprimi për luftën kundër HIV-it, ka forcuar sistemet e testimit në të gjithë vendin dhe ofron trajtim falas për pacientët me SIDA. Pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët, përfshirë përfaqësues të Shoqatës së Njerëzve me HIV, shkëmbyen pikëpamjet e tyre dhe përshkruan sfidat dhe pengesat me të cilat përballen në punën e tyre të përditshme. Në një konferencë për shtyp në vijim të aktivitetit, pjesëmarrësit diskutuan në mënyrë konstruktive se si mund të angazhohet më shumë shoqëria civile dhe ranë dakord për nevojën e programeve më të pikësnyuara për ata në rrezik më të madh për t’u infektuar. Një konferencë për shtyp u zhvillua edhe nga Ministri i Shëndetësisë, Petrit Vasili. “SIDA ka shkaktuar vuajtje të patreguara dhe vdekje. Por një ngjarje tjetër është shpalosur gjatë viteve, ajo e njerëzve në mbarë botën, të bashkuar me pasionin për të vepruar. Këto përpjekje po sjellin ndryshimin e vërtetë”, tha Përfaqësuesi i UNICEF-it, Detlef Palm. “Por nuk ka mbaruar ende”, shtoi ai. “Shqipëria nuk e ka kaluar kulmin e epidemisë. Ne duam të ndihmojmë që përgjigja ndaj HIV-it të përqafojë shëndetësinë, dinjitetin, sigurinë dhe solidaritetin; dhe jo stigmën, diskriminimin dhe dënimin. Puna nuk quhet ende e përfunduar deri sa të kemi zero infeksione, zero vdekje nga SIDA dhe zero diskriminim”.

Takim i Grupit Sektorial të Punës të TIK-ut

Më 15 dhjetor 2010, Ministria për Inovacion dhe TIK organizoi takimin e dytë për vitin 2010 të Grupit Sektorial



Foto: 1 dhjetor 2010 – Veprimtaritë në Ditën Botërore kundër SIDA-s në Hotel Sheraton

të Punës për TIK-un. Ministri Genc Pollo drejtoi takimin, qëllimi i të cilit ishte analizimi i përparimit në këtë sektor, politikat e reja të zbatuara për të zhvilluar TIK-un dhe shoqërinë e informacionit, dhe hapat e mëtejshëm. Ministri Pollo bëri një përshkrim të përgjithshëm të situatës së sotme në këtë sektor, politikave të reja dhe arritjeve të deritanishme, si dhe të prioritetëve në TIK. Ai ftoi donatorët të mbështesin prioritetet e Qeverisë në këtë sektor, sepse zhvillimi i tij luan rol kryesor në zhvillimin social-ekonomik të vendit. Shefi i Kabinetit të Ministrisë, Gjergji Gjinko, bëri një prezantim të hollësishëm të fushave që kanë nevojë për mbështetje të mëtejshme financiare nga donatorët, siç janë biblioteka dixhitale, arsimit online, pjesëmarrja elektronike e qytetarëve në vendim-marrje (përfshirja elektronike) dhe shërbimet publike online. Pjesëmarrësit ishin përfaqësues të Delegacionit të BE-së, Bankës Botërore, OKB-së, Italisë, Austrisë dhe Zvicrës.

Axhendë e re për rritjen e ardhshme ekonomike të Shqipërisë

Më 13 dhjetor 2010, Banka Botërore prezantoi në Tiranë Axhendën e re për rritjen (ose Memorandumin Ekonomik për Shqipërinë). Raporti argumenton se Shqipëria mund të ruajë ritmet e rritjes ekonomike në të ardhmen vetëm përmes zbatimit të një modeli të ri politikash dhe reformash të përqendruara kryesisht në arsim, aftësitë, zhvillimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, sektorin e energjisë, qeverisjen më të mirë dhe zbatimin e ligjit. Për përgatitjen e raportit Banka angazhoi një ekip ekspertësh vendorë dhe ndërkombëtarë. Raporti eksploron burimet për

rritjen e ardhshme ekonomike ndërkohë që Shqipëria hyn në një fazë të re zhvillimi. Në përfundim raporti sugjeron se nevojiten investime të mëtejshme në kapital njerëzor, veçanërisht në fushat e arsimit dhe formimit. Në të gjithashtu shqyrtohen zhvillimet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, klima e investimeve, sektori financiar dhe propozohen masa për përmirësimin e nivelit ekonomik të Shqipërisë si një nga vendet në nivelin e sipërm me të ardhura të mesme. “Arritja e statusit mes vendeve në nivelin e sipërm me të ardhura të mesme brenda një kohe relativisht të shkurtër përbën një arritje të madhe. Por njëkohësisht sjell sfida të reja. Me këtë status të ri, Shqipërisë i duhet të konkurrojë me vende të varfra me paga të ulëta si dhe me novacionet e vendeve të pasura”, tha Kseniya Lvovsky, Menaxhere e Zyrës së Bankës Botërore për Shqipërinë në fjalën e saj prezantuese të raportit. Ky raport vijon studimet të tjera të kohëve të fundit të Bankës Botërore, të cilat rekomandojnë përmirësimin e sistemit arsimor dhe të infrastrukturës së TI-së në vend. Shqipëria ka bërë përpjekje të konsiderueshme për të përmirësuar klimën e vendit dhe për t’u përgatitur për hyrjen e mundshme në BE, duke miratuar një numër të madh ligjesh dhe aktesh-nënligjore. Për të plotësuar këto masa, një çështje kritike për firmat është shkalla në të cilën Qeveria u përmbahet ligjeve dhe akteve-nënligjore ekzistuese dhe i zbaton ato në mënyrë të njëtrajtshme dhe koherente. Raporti u paraqit nga një ekip ekspertësh të Bankës Botërore dhe u pasua nga një diskutim i frytshëm i përfaqësuesve të Qeverisë, shoqërisë civile, sektorit privat dhe donatorëve. Ky raport synon të kontribuojë në debatin e nisur të shoqërisë shqiptare për axhendën e re të rritjes. Për të lexuar këtë raport, ju lutemi vizitoni [këtu](#).

Sondazhi i vitit 2011 për Monitorimin e Deklaratës së Parisit

Raundi i tretë i Monitorimit e Deklaratës së Parisit filloi në dhjetor 2010 dhe do të përfundojë në mars 2011. Në përgatitje për anketimin e vitit 2011 për Monitorimin e Deklaratës së Parisit, PNUD dhe OECD organizuan një sërë seminaresh rajonale, me synimin për të siguruar që aktorët kryesorë të përfshirë në administrimin e anketimit, të informohen për objektivat, proceset dhe aspektet teknike të sondazheve të vitit 2011, si edhe proceseve të tjera të lidhura me të – përfshirë Sondazhin e vitit 2011 të UN DESA/PNUD për llogaridhënien reciproke. Seminaret synuan edhe forcimin e komuniteteve rajonale të praktikës, duke shërbyer si një platformë për shkëmbimin e përvojës dhe praktikave më të mira, dhe mbledhjen e mendimeve dhe shqetësimeve të vendit partner, për t'i përcjellë në Forumin e Katërt të Nivelit të Lartë për Efektivitetin e Ndihmës, që do të zhvillohet në Republikën e Koresë në dhjetor 2011. I bashkë-organizuar nga Qeveria e Jordanisë, Qeveria e Irakut, OECD dhe PNUD, seminari rajonal për Shtetet Arabe, Evropën dhe Komonuelthin e Shteteve të Pavarura u zhvillua në Detin e Vdekur, Jordani, më 8-9 dhjetor 2010. Në të morën pjesë 20 përfaqësues qeverish dhe 15 pika kontakti të donatorëve të Sondazhit për Deklaratën e Parisit nga 11 vendet / territoret partnere, përfshirë Shqipërinë. Gjatë ditës së parë të seminarit, Koordinator i DEBASKON-it, Klodjan Seferaj, bashkë me panelistët nga Maroku, Jordania dhe Egjipti, shkëmbyen përvojat e vendeve të tyre në lidhje me përparësitë për efektivitetin e ndihmës dhe të zhvillimit në vendet me të ardhura të mesme. Diskutimet në grup dhe ato plenare nxorën në pah një gamë çështjesh konkrete për secilin prej vendeve të këtyre rajoneve, që kanë të bëjnë me Sondazhin e vitit 2011 dhe me axhendën për efektivitetin e ndihmës në përgjithësi. Seminari u karakterizua nga nivele të larta të përqendrimit, gatishmëria për të shfrytëzuar mundësinë për të siguruar të kuptuar të shëndoshë të procesit të Sondazhit të vitit 2011 dhe të diskutimeve dhe debateve të gjalla që shkuan përtej Sondazhit të Deklaratës së Parisit. Materialet e paraqitura në këto seminare gjenden këtu.



Foto: Koordinator i DEBASKON-it, Klodjan Seferaj, bashkë me panelistët nga Maroku, Jordania, dhe Egjipti, duke shkëmbyer përvojat e vendeve të tyre lidhur me përparësitë për efektivitetin e ndihmës dhe të zhvillimit në Vendet me të ardhura të mesme.

Misionet në vend

Misioni i Projektit të Bankës Botërore për Zbutjen dhe Përshtatjen ndaj Rrezikut të Fatkeqësive në Shqipëri vizitoi vendin tonë në datat 1 deri në 7 dhjetor 2010. Qëllimi parësor i misionit ishte të vlerësonte, bashkë me agjencitë homologe, statusin e të gjitha veprimtarive të projektit; të identifikonte pengesat në zbatim; të rishikonte planin e punës, lëvrimet për prokurime, si dhe çështjet e menaxhimit financiar; dhe të diskutonte për masat për të përsheptuar përparimin në realizimin e objektivave të projektit. Bashkë me homologët e Qeverisë, misioni vlerësoi edhe rezultatet e projek-

tit dhe të kuadrit monitorues, përfshirë pikësynimet dhe treguesit konkretë të rezultateve për rishikime të mundshme.

Misioni i Projektit të Kontrollin e Gripit të Shpendëve dhe Parapërgatitjen dhe Përgjigjen ndaj Sëmundjeve Pandemike në Shqipëri zhvilloi vizitë në vendin tonë në datat 13 deri në 17 dhjetor 2010. Qëllimet e misionit ishin: i) të vlerësonte përparimin e arritur në zbatimin e komponentëve të projektit dhe veprimeve të rëna dakord në misionet mbikëqyrëse të 4 qershorit 2010, si dhe përfundimin e projektit, ii) të sigurohej që treguesit e projektit dhe të performancës së komponentëve po arrihen dhe po pasqyrohen si duhet në raportet përfundimtare të Sekretariatit të Grupit të Punës, dhe iii) të udhëzonte stafin e projektit në përfundimin e Raportit të Përfundimit të Projektit të Huamarrësit (RPP).

dialoguqeveridonatorë

Nga data 15 dhjetor 2010 Banka Botërore mori Kryesimin e Sekretariatit Teknik të Donatorëve nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim.

Të gjitha komentet lidhur me Dialogun Qeveri-Donatorë janë më se të mirpëritura!

Doni të kontribuoni?

Nëse dëshironi të kontribuoni, dërgoni tekstin tuaj në zyrën e Sekretarit Teknik të Donatorëve (nevila.como@aidharmonisation.org.al) ose në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj (akabashi@km.gov.al) deri më datë 5 të çdo muaji. Teksti duhet të jetë mundësisht rreth 100 fjalë.

Shpërndarja:

Çdo botim do t'ju dërgohet më datë 15 të çdo muaji.

Cilët janë donatorët në Shqipëri?

Për të zbuluar cilët janë donatorët që operojnë në Shqipëri, klikoni këtu.

Për t'u çregjistruar:

Lutemi dërgoni e-mail tek Nevila Çomo (nevila.como@aidharmonisation.org.al)

Buletini "Dialogu Qeveri-Donatorë" mbështetet nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

osce

